



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KD. Nr.10-4/2021

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, Kolegji Disiplinor i përbërë nga Fitim Shporta (kryetar), Agron Curri dhe Violeta Jashari (anëtarë), me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 92-4/2019 të dt. 27.10.2021, të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, kundër avokatit _____ me adrese, rr. _____ nga Prishtina, në bazë të nenit 51 paragrafi 1, nënparagrafi, 1.1. të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, lidhur me nenin 122 të Statutit të OAK-së dhe nenit 35 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit kryesor disiplinor, me dt. 22.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, avokat _____ me zyre në _____, rr. _____, me nr. të licences reg.nr.1192/2010 dt.17.12.2010 të OAK-së.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

I paraqituri, av. _____, nga data 23.10.2019 ne fjalën perfundimtare e deri me datën 20.05.2020 ne Kerkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ne lenden penale PAKR.nr.71/2020 te mbrojturit te tij te pandehurit _____, ka perdorur shprehje jo adekuate me te cilat ka fyer gjykatesin e rastit _____

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 37,38 dhe 39 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, sepse me deklarimet e bera ka vepruar ne kundërshtim me aktet normative te OAK-se,

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në pajtim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Avokatinë, nenit 122 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit, avokatit _____, i shqipton masën disiplinore:

I. VËREJTJE

II. Obligohet i paraqitur av. _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) euro.

III. Pagesa paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Me dt.,27.10.2021,Prokurori Disiplinor i OAK-së, në Komisionin Disiplinor ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 92-4/2019, kundër të paraqiturit, av. _____ nga _____, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore kundër tij dhe t'i shqiptohet masa disiplinore për shkelje nga neni 118 paragrafi 1.3 i Statutit të OAK-së, lidhur me nenet 37,38 dhe 39 të Kodit të Etikës për Avokatë. Propozimi është bërë në bazë të fletëparaqitjes – kërkesës për inicim të procedurës disiplinore ZPD.nr. 92/19 të palës-gjyqtarit _____, i cili pretendonte se i paraqituri si ne fjalën perfundimtare te dt.23.10.2019 si edhe ne Kerkesen per mbrojtjen e ligjshmerise te ushtruar me dt.20.05.2020 ne vazhdimsi ne nje ceshtje penale ka perdorur shprehje jo adekuate me te cilat ka fyer ate si gjykates te rastit.

Kolegji disiplinor, me dt. 11.11.2021, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi propozimin e Prokurorit Disiplinor nr. 92-4/2019, dt. 27.10.2021, me provat e bashkëngjitura, konstatoi se ekziston arsyeja bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____.

Kolegji Disiplinor, mbajti seancën e shqyrtimit kryesor më datën 22.12.2021, në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, z. Rexhep Veseli, të paraqiturit av. _____, në mungesë të ushtruesit të fletëparaqitjes gjyqtarit _____, i cili e kishte pranuar ftesën në mënyrë të rregullt.

Kolegji Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 29, 30,31, 33 dhe 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore dhe deklarimin e të paraqiturit dhe të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, pasi nuk kishte vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, si dhe konstatimit se i paraqituri ka pranuar me kohë propozimin disiplinor dhe të gjitha provat e bashkëngjitura, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor me nr. 92-4/2019 të datës 27.10.2021. Propozimin Disiplinor e lexoi Prokurori Disiplinor, z. Rexhep Veseli duke mbetur edhe më tej pranë propozimit.

